



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 3779/1 Prishtinë 04-11 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti Albert Salltakaj ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: " Ndikimi I zbatimit të teknologjisë GIS në monitorimin e shfrytëzimit të ujit në qytetin e Prizrenit " në programin e studimeve Master Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Me zhvillimin e teknologjisë paralelisht janë zhvilluar edhe softuerët të cilët lehtësojnë punën, shkurtojnë kohën, zvogëlojnë koston, rrisin precizitetin dhe zvogëlojnë devijimin në analizën në përpunimin e të dhënave. Qëllimi i punimit është pasqyrimi, prezantimi dhe shfrytëzimi i mundësisë që sistemi GIS ofron, dhe njëherit ofrimin e studimit tek palët tjera.

Një prej sfidave që kanë sot Kompanitë e Ujësjellësit në Kosovë duke përfshirë edhe Ujësjellësin e Prizrenit lidhet me menaxhimin e infrastrukturës ujore dhe humbjeve e ujit.

Punimi trajton pikërisht aplikimin e GIS si një sistem ndihmës në menaxhimin më të mirë të infrastrukturës ujore dhe humbjeve të ujit. Shkalla e humbjeve të ujit me rreth 55% në sistemin e furnizimit tregon se duhet të aplikohen metoda të njohura në fushën e identifikimit të zonave me humbje në mënyrë që ato të zvogëlohen në një shkallë të pranueshme. Për këtë qëllim punimi trajton një zonë në qytetin e Prizrenit, zonën Dardania ku është aplikuar GIS si sistem ndihmës në procesin e hulumtimit të humbjeve të ujit. E gjithë zona e studimit është kompletuar në sistemin GIS me të gjitha të dhënat duke përfshirë edhe lidhjen e databazës së faturimit. Në zonë janë instaluar tre ujëmatës kryesor që monitorojnë pandërprerë të dhënat për prurjet të cilët po ashtu janë të lidhur me GIS. Të dhënat e gjeneruara tregojnë se në këtë zonë janë 754 konsumatorë dhe rezultatet e studimit tregojnë për një nivel të lartë të humbjeve. Kështu, në vitin 2020 në bilancin ujor në zonë janë regjistruar 588,785 m³ hyrje të ujit ndërsa janë faturuar vetëm 116,209 m³. Kjo tregon se uji i pa faturuar ishte rreth 80%. Rezultatet përafërsisht të njëjta ishin edhe në vitin 2021, ku nga 857,093 m³ ujë, janë faturuar vetëm 166,716 m³ dhe uji i pa faturuar është 80.55%. Nuk ka një progres në vitin 2021 krahasuar me 2020, humbjet mbesin në shkallë më të lartë. Në punim tregohet që aplikimi i GIS-it është një mundësi shumë e dobishme që mund tu shërbej kompanive të ujësjellësve, sidomos në procesin e menaxhimit ditor në fushën e monitorimit të infrastrukturës dhe në procesin e zvogëlimit të humbjeve.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.